



Federata Aeronautike e Kosovës

RREGULLORJA PËR PJESËMARRJE NË AKTIVITETE TË ORGANIZUARA NGA FAK

Kryesia e Federatës Aeronautike të Kosovës në mbledhjen e vet të mbajtur më 04.03.2015, aprovoi:

RREGULLOREN 01/2015

PJESËMARRJE NË GARAT KOMBËTARE TË ORGANIZUARA NGA FAK, DISCIPLINA PARAGLLAJDIZËM

Neni 1

Në garat e kampionatit kombëtar të organizuara nga FAK mund të marrin pjesë të gjithë pilotët anëtarë të ndonjë klubi të anëtarësuar në FAK të cilët janë të licensuar si pilotë nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës ose nga ndonjë autoritet tjetër ndërkombëtarë i aviacionit.

Neni 2

Organizatori i garës së kampionatit kombëtar (FAK) është i obliguar të publikoj në internet kriteret dhe rregulloret për secilën garë në të cilën FAK figuron si organizator ose bashkë-organizatorë.

Neni 3

Të gjithë pilotët pjesëmarrës në garat e kampionatit kombëtar të organizuara nga FAK, me pjesëmarrjen e tyre në garë në mënyrë automatike pajtohen me të gjitha kriteret dhe rregulloret e caktuara të garës përkatëse që organizohet nga FAK.

PJESËMARRJE NË GARAT TË KLUBEVE TË ORGANIZUARA, DISCIPLINA PARAGLLAJDIZËM

Neni 4

Në garat e klubeve të organizuara në Kosovë mund të marrin pjesë të gjithë pilotët dhe nxënësit anëtarë të ndonjë klubi të anëtarësuar në FAK.

Neni 5

Klubi organizator i garës, është i obliguar të publikoj në internet kriteret dhe rregulloret për garn t ciln e organizon.

Neni 6

Të gjithë pilotët pjesëmarrës në garat e klubeve të organizuara në Kosovë, me pjesëmarrjen e tyre në garë në mënyrë automatike pajtohen me të gjitha kriteret dhe rregulloret e caktuara të garës përkatëse që organizohet nga FAK.



Federata Aeronautike e Kosovës

PJESËMARRJE NË AKTIVITETE STËRVITORE

Neni 7

Në aktivitetet stërvitore të organizuara nga Federata Aeronautike e Kosovës mund të marrin pjesë të gjithë pilotët dhe nxënësit anëtarë të ndonjë klubi të anëtarësuar në FAK.

Neni 8

Federata Aeronautike e Kosovës njofton për aktivitetet stërvitore klubet anëtare të federatës.

PJESËMARRJE NË AKTIVITETE TË LIRA DHE FLUTURIME REKREATIVE

Neni 9

Në aktivitetet rekreative të organizuara nga Federata Aeronautike e Kosovës mund të marrin pjesë të gjithë pilotët dhe nxënësit anëtarë të ndonjë klubi të anëtarësuar në FAK.

Neni 10

Federata Aeronautike e Kosovës njofton për aktivitetet reaktive klubet anëtare të federatës.

Neni 11

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyre dhe procedurë të njejtë sikur me rastin e miratimit të saj, pra ndryshimet propozohen nga komisioni për parajllajdzëm në kuadër të FAK si dhe dëgohen për votim në kryesinë e FAK.

Neni 11

Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit.

Prishtinë, 04.03.2015

Kryesia Federatës Aeronautike të Kosovës